

RAPORTI VJETOR

2016


Organizata 'Të ndryshëm dhe Të Barabartë'



**DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHEM & BARABARTE**

MISIONI

Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë është e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të abuzimit, të shfrytëzimit dhe të trafikimit, dhe për të përmirësuar kontekstin ligjor, institucional dhe social në mënyrë të tillë që t'i kundështojë këto abuzime.



Përmbajtja

Projektet e zbatuara gjatë periudhësjanar – dhjetor 2016 dhe donatorët.....	4
1. Përfituesit/et e programit.....	5
1.1 Profili i rasteve VeT/VMT.....	5
1.2 Profili i rasteve viktime të abuzimit dhe dhunës në familje.....	6
2. Shtyllat kryesore të punës së D&E.....	10
2.1 Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktime të abuzimit, trafikimit dhe dhunës në familje.....	11
2.2 Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit,VTM apo viktime të dhunës në familje.....	23
2.3 Asistencë direkte për meshkuj viktime të abuzimit, trafikimit dhe dhunës.....	25
2.4 Rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.....	26
2.5 Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale.....	28
2.6 Aktivitete ndërgjegjësuese për trafikimin.....	28
2.7 Aktivitete për parandalimin e dhunës seksuale.....	35
3. Trajnime dhe prezantime të ofruara nga D&E.....	37
4. Pjesëmarrje të stafit në trajnime.....	37
5. Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit.....	39
6. Aktivitet për rritje fondesh.....	40
7. Botime dhe publikime të D&E.....	41

Projektet e zbatuara gjatë periudhës janar – dhjetor 2016

■ **Projekti 1:** “Rritja e përpjekjeve për riintegrimin e viktimave të trafikimit në Shqipëri”
Donator: “Pro Victims”
Kohëzgjatja: - 1 tetor 2014 – 30 shtator 2016

■ **Projekti 2:** “Sigurimi i asistencës riintegruese të qëndrueshme për viktimat e trafikimit dhe atyre në risk trafikimi”
Donator: UNODC
Kohëzgjatja: prill 2015 – mars 2017

■ **Projekti 3:** “Qender për aktivitete edukative për viktimat e trafikimit”
Donator: “Mary Ward Loreto”
Kohëzgjatja: 2 vjet (vazhdon)

■ **Projekti 4:** “Cikli i këshillimit”
Donator: “Swiss Contact”
Kohëzgjatja: janar – dhjetor 2016

■ **Projekti 5:** “Rritja e përpjekjeve riintegruese për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri dhe ofrimi i aktiviteteve ndërgjegjësuess për personat në nevojë dhe profesionistët kyç.”
Donator: “Renovabis”
Kohëzgjatja: nëntor 2014 – tetor 2017 (3 vjet)

■ **Projekti 6:** “Informimi i komunitetit mbi trafikimin e grave dhe vajzave dhe zgjedhjet alternative”
Donator: “UN WOMEN”
Kohëzgjatja: shtator 2015 – shkurt 2016

■ **Projekti 7:** “Our Voices”
Donator: “University of Bedfordshire”
Kohëzgjatja: 2013-2016

■ **Projekti 8:** “Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushata antitrafikimi”
Donator: “Ambasada Amerikane”
Kohëzgjatja: korrik 2016 – qershor 2017

■ **Projekti 9:** “Modelimi dhe integrimi i shërbimeve alternative (paradite dhe mbasdite) të përkujdesjes së fëmijëve. Për fëmijët e nënave që janë duke rindërtuar jetën e tyre”
Donator: “Save the Children”

Kohëzgjatja: dhjetor 2016 – maj 2018

- **Projekti 10:** “Asistencë për riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”

Donator: Qarku, Tiranë

Kohëzgjatja: janar – dhjetor 2016

1. Përfituesit/et e programit

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2016 janë asistuar në programin riintegruës të organizatës **113 përfitues/e dhe 89 fëmijë të tyre** nga të cilat **44 raste dhe 43 fëmijëtë tyre** kanë hyrë për herë të parë në program gjatë kësaj periudhe, ndërsa rastet e tjera janë të mbartura nga viti i kaluar dhe kanë vazhduar të marrin ndihmë sipas planit të riintegrimit.

Nga rastet e reja të referuara, **28 raste janë VT/VMT; 1 rast i abuzimit seksual dhe 15 raste janë viktima të dhunës në familje. (Për më shumë info tab. poshtë)**

- **Kategoritë e përfitueseve të asistuar në program**

Kategoria	Total i rasteve të asistuar në program gjatë periudhës janar – dhjetor 2016	Rastet e mbartura nga dhjetor 2015	Rastet e reja në program gjatë periudhës janar – dhjetor 2016
Viktima trafikimi / viktima të mundshme trafikimi	85	57	28
Viktima të dhunës dhe abuzimit	28	12	16
Fëmijë të rasteve VeT shoqëruar me nënat e tyre	33	21	12
Fëmijë të rasteve VDH të shoqëruar me nënat e tyre	56	25	31
Totali	202	115	87

TABELA NR.1

1.1 Profili i rasteve viktima / viktima të mundshme trafikimi

- **Gjinia**

Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja	Total
Femra	42	23	65


Meshkuj	15	5	20
TOTAL	57	28	85

■ **Mosha**

Mosha	14-17	18-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Numri i rasteve	6	15	5	1	1	28

TABELAT NR 2/3

■ **Mënyrat e rekrutimit**




GRAFIKU NR 1

■ **Vendi ku kanë qenë trafikuar**

Vendi ku janë shfrytëzuar	Nr i rasteve
Shqipëri	19

Itali	1
Greqi	1
Angli	1
Serbi	1
Shqipëri, Itali, Kosovë	1
Shqipëri, Greqi, Itali	1
Shqipëri, Itali	1
Zvicër, Gjermani	2

TABELA NR 4




GRAFIKU NR 2

■ Format e shfrytëzimit

Forma e shfrytëzimit	Nr i rasteve
Shfrytëzim seksual	20
Punë e detyruar	2
Lypje	1
Aktivitet kriminal	1
Shfrytëzim seksual, aktivitet i ulët	3

TABELA NR 5



GRAFIKU NR 3

■ Referimet e rasteve sipas muajve

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	2	0
Shkurt	5	3
Mars	3	5
Prill	1	0
Maj	2	1
Qershor	1	0
Korrik	3	1
Gusht	2	1
Shtator	4	0
Tetor	2	0
Nëntor	1	0
Dhjetor	2	1
TOTAL	28	12

TABELA NR 6

■ Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2016

Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
Drejtoria e Policisë, Tiranë	2
Drejtoria e Policisë, Berat	2
Drejtoria e Policisë / ZRSHSSH, Durrës	3
Drejtoria e Burgjeve, Burgu 325	1
Bashkia Tiranë	1
Avokati i Popullit	1

QKPVT	4
Qendra psiko-sociale “Vatra”	1
Skuadra e Terrenit	1
ARSIS	3
Forumi i Gruas Elbasan	1
Qendra komunitare “Sot për të ardhmen”	1
Aleanca LGBT	1
Good Sepherd Sister (Institucion Fetar)	2
Salvation Army, UK	1
Vetëreferuar	2
IOM	1
TOTAL	28

TABELA NR 7

1.2 Profili i viktimave të dhunës në familje dhe abuzimit

■ Gjinia

Gjinia	Numri i rasteve të mbartura	Numri i rasteve të reja	TOTAL
Femra	12	15	27
Meshkuj	0	1	1
TOTAL	12	16	28

TABELA NR 8

■ Moshë

Moshë	16-18	18-25	26-30	31-35	Mbi 36	Total
Numri i rasteve	1	6	3	3	3	16

TABELA NR 9

■ Referimet e rasteve sipas muajve


16 raste dhe 31 fëmijë kanë hyrë në program gjatë kësaj periudhe.

Muaji	Nr i rasteve të referuara	Nr i fëmijëve
Janar	0	1
Shkurt	0	0
Mars	0	0
Prill	2	6
Maj	3	5

Qershor	1	2
Korrik	4	12
Gusht	2	1
Shtator	1	1
Tetor	0	0
Nentor	3	3
Dhjetor	0	0
TOTAL	16	31

TABELA NR 10

■ Burimi i referimit për rastet e reja të asistuar gjatë periudhësjanar – dhjetor 2016



GRAFIKU NR 4

2. Shtyllat kryesore të punës së D&E gjatë periudhës janar- dhjetor 2016

Aktivitetet kryesore të zbatuara nga organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" për periudhën janar - dhjetor 2016 janë:

Asistence direkte per vajzat dhe gratë viktima të abuzimit, trafikimit dhe dhunës në familje.

Asistencë direkte per meshkuj viktima të abuzimit, trafikimit dhe dhunës.

Rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale

Aktivitete ndërgjegjëse për parandalimin e dhunës seksuale

Aktivitete ndërgjegjëse për trafikimin

Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit, VMT apo viktima të dhunës në familje

2.1 Asistencë direkte për vajzat dhe gratë viktima të abuzimit, trafikimit dhe dhunës në familje

D&E ka vazhduar të ofrojë asistencë riintegruese për viktimat e trafikimit në tre faza:



■ Një paketë e plotë shërbimesh riintegruese është ofruar për përfituesit/et e programit të D&E:

TE NDRYSHEM DHE TE BARABARTE

- Strehim, siguri, plan riintegrimi, asistencë e menjëhershme mjekësore.
- Negocim/ndërmjetësi m me familjen. Vlerësime dhe këshillime psikologjike.
- Mbështetje dhe asistencë ligjore.
- Asistencë për rregjistrim/vazhdimë sinë e sistemit shkollor.



- Trajnime profesionale.
- Aktivitete sociale.
- Këshillim dhe ndihmë për punësim.
- Mbështetje financiare për strehim.
- Informacion për shërbimet që ekzistojnë në komunitet si dhe kontaktet e nevojshme.
- Programe pune që krijojnë të ardhura.
- Asistencë dhe mbështetje për fëmijët e viktimave të trafikimit.



TE NDRYSHEM DHE TE BARABARTE

- Monitorime dhe ndjekja e njëpasnjëshme e përfituesve të programit.
- Përveç asistencës direkte me përfitueset, D&E ka punuar e mbështetur dhe familjen e viktimës, p.sh fëmijet e përfitueses, asistencë për prindin e një minoreni që të gjejë punë , këshillim familjar etj..

■ Shërbime psikologjike e psiko-sociale

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, janë ofruar 2791 seanca këshillimi individuale për përfituesit nga rasteve. menaxherët e

Duke iu referuar shërbimit psikologjik janë realizuar:

- *Këshillim individual* psikologjik dhe psiko-social në RC dhe në Qendrën e Edukimit
- *Këshillimi në grup*
- *Terapi arti*
- *Terapia okupacionale*

TABELA 11

■ Këshillimi psikologjik

Gjatë periudhës së raportimit janë realizuar 1113 seanca të këshillimit individual nga psikologia. Përfitueset janë asistuar në trajtimin e simptomave të depresionit, ankthit, stresit posttraumatik, pasojat e abuzimit dhe traumave.



”Këshillimi më ka ndihmuar që të jem më e qetë nga ana shpirtërore” – B.18

” Ka disa kohë që marr këshillim dhe kam kuptuar shumë nga gjërat që më kanë ndodhur dhe kam kuptuar çfarë dua të bëj në të ardhmen.”-A.17.

” Tani kam më pak ankth sepse kam folur për gjëra që nuk kam folur kurrë më parë, gjëra që i mbaja për vete” – O.1

FIGURA 1

Nr	Asistenca Psikologjike	Nr. seancave
1	Seanca individuale këshillimi	1113
2	Terapi arti në grup	61
3	Terapi okupacionale	59

TABELA 12

■ Terapi arti në grup



FIGURA 2



FIGURA 3

Gjatë periudhës së raportimit, në seancat e “Terapisë së artit” janë përfshirë rreth 15 përfituese dhe janë realizuar 61 seanca grupi. Seancat mbështeten nga psikologjia dhe asistohen edhe nga 2 vullnetare të organizatës. Përfitueset shprehen kështu për sesionet e “Terapisë së artit”:

„ Nuk më ka pëlqyer kurrë të vizatoj, por këtu ndihem shumë e qetë kur e bëj“– P. 20

„ Kur vizatoj, futem në një botë relaksi, ndihem e lumtur dhe e përqëndruar. Mezi i pres takimet „ – I. 18

■ Terapi okupacionale

Një herë në javë përfitueset përfshihen në një aktivitet ku zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese. Gjatë kësaj ore argëtuese ato krijojnë gjëra të ndryshme me materiale të riciklueshem. Përfitueset angazhohen plotësisht duke e konsideruar jo vetëm si aktivitet, ku ndihen të vlefshme për krijimet e tyre, por edhe relaksohen.



FIGURA 4



FIGURA 5



FIGURA 6

“Ky është një aktivitet relaksues që më jep mundësinë të krijoj ., A, 17 vjece

„Nuk e dija që më pëlqen kaq shumë arti dhe që mund të krijoja bizhu kaq të bukura. Në fillim nuk doja të përfshihesha se më dukej se nuk dija të vizatoja., - Z.18

“E shijoj shumë kohën në këtë orë, dëgjojme muzikë dhe krijojmë sende të ndryshme, p.sh piktura, kafshë, bizhuteri, maska etj.”- E.25

■ Terapi arti dhe loje me fëmijët e përfitueseve

Gjatë periudhës së raportimit, janë asistuar edhe fëmijë të përfitueseve, me seanca këshillimi individuale. Është ndërhyrë përmes artit dhe lojës për të trajtuar disa vështirësi që fëmijët shfaqnin për shkak të ekspozimit ndaj dhunës. Këto seanca kanë përfshirë vlerësimin fillimisht e më pas trajtimin në varësi të nevojave të fëmijëve.

■ Asistencë për fëmijët e përfitueseve

Gjatë kësaj periudhe janë asistuar në programin e D&E 89 fëmijë të shoqëruar me nënat e tyre nga ku 6 fëmijë janë ndihmuar në Qendrën e Riintegritimit dhe 83 janë asistuar bashkë me nënat në fazën e dytë të programit.

■ Fëmijët e rasteve të asistuar në program

	Totali i fëmijëve të rasteve të asistuar	Fëmijë të rasteve të mbartura nga	Fëmijë të rasteve të reja në
--	--	-----------------------------------	------------------------------

Kategori	në program gjatë periudhës janar – dhjetor 2016	dhjetor 2015	program gjatë periudhës janar – dhjetor 2016
Fëmijë të rasteve VeT shoqëruar me nënat e tyre	33	21	12
Fëmijë të rasteve VDH shoqëruar me nënat e tyre	56	25	31
Total	89	46	43

TABELA 13

- 36 fëmijë tëpërfitueseve kanë shkuar rregullisht në çerdhe dhe në kopësht nga ku **17 janë fëmijë të VT/VMT**;
- 29 fëmijë kanë ndjekur rregullisht shkollën nga ku **8 janë fëmijë të VT/VMT**;
- Të gjithë fëmijëtkanë bërë vaksinatnë bazë tëskemëssë vaksinimitdhejanë ndjekurrregullisht ngapediatri;

■ Asistencë shëndetësore

Stafi mjekësor i D&E ka adresuar dhe trajtuar nevojat mjekësore të përfitueseve të programit të Qendrës së Riintegritimit. Këto lloje shërbimesh janë ofruar kryesisht për përfitueset që janë të akomoduar në Qendrën e Riintegritimit, por edhe për ato të cilat janë në fazën e dytë të programit. Pas vlerësimit mjekësor të realizuar nga doktoresha, rastet e reja të sapo hyra në program janë mbështetur të bëjnë analizat rutinë (gjak komplet, urina, ekzaminimet SST, etj).

Dy përfituese shtatzanë janë mbështetur me asistencën e duhur mjekësore dhe një prej tyre ka lindur gjatë kësaj periudhe.

■ Diagnoza mjekësore

Sëmundja	Infeksione urinare	Probleme gastro-intestinale	Probleme dermatologjike	Colic abdominal and renal	ORL problems	Probleme alergjike	Probleme gjinekologjike	Anemia	Probleme dentrae	Oculist	Probleme neurologjike	Probleme reumatizmale
Nr. i rasteve		9	3	6	14	2	7	4	9	7	1	1
Fëmijë		2	2		3	2		1	1			

TABELA 14

■ Ekzaminimet mjekësore

Ekzaminimet	STD		HIV/AIDS	
	Ekzaminuar	Pozitive	Ekzaminuar	Pozitive
Nr. i rasteve	6	3	6	0

TABELA 15

■ Probleme të shëndetit mendor

Çrregullime mendore/sëmundje	Përfituese	Fëmijë
PTSD	2	
Epilepsi		1
Çrregullim personaliteti /Borderline	3	
Çrregullime të depresionit	5	
Çrregullim ankthi	1	
Skizofreni	2	
Çrregullim psikotik	1	
Autizëm		1

TABELA 16

Rastet që kanë rezultuar pozitiv për STD kanë qenë me diagnozat: Candida, Gonorrhea dhe Trichomonas vaginalis. Fatmirësisht asnjë rast me Hepatit apo HIV (+)

- Eshte realizuar pajisja me kartat e shëndetit të përfitueseve të asistuar në programin e D&E. Rreth **60 përfitues** janë pajisur me karta shëndeti. Këta përfitues kenë patur mundësinë të marrin shërbim shëndetësor falas pranë mjekes së tyre të familjes në QSH Nr 9, në Tiranë. Ky shërbim do të ofrohet për një periudhe 1- vjeçare, me të drejtë rinovimi.
- D&E ka vazhduar bashkëpunimin me *Albanian University, Dega Stomatologji*, nëpërmjet të cilit janë siguruar shërbime dentare falas për përfitueset e programit dhe gjithashtu me *“Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor nr.1 dhe 2” dhe ISHP.*
- Stafii mjekësor ka organizuar diskutime në grup mbi çështjet e shëndetit si: infeksionet seksualisht të transmetueshme, ushqyerja e femijes 0-12 muajsh, higjiena personale, mbrojtja nga temperaturat e uleta.

■ Asistencë ligjore

D&E ka ofruar asistencë ligjore për të gjithë përfituesit në program nëpërmjet juristit të D&E si dhe përmes bashkëpunimit me Qendrën për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNLQ). Për të gjitha rastet e reja është bërë vlerësimi ligjor brenda 10 ditëve të para të përfshirjes në programin e organizatës “Të Ndryshëm & Të barabartë”. Vlerësimet ligjore kanë shërbyer për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të rastit dhe për të identifikuar nevojat e tyre për asistencë ligjore. Sipas kërkesave të rastit janë zhvilluar edhe takime individuale për problematika të ndryshme ligjore, që rastet kanë gjatë qëndrimit në program. Gjithashtu janë zhvilluar edhe tema në grup sipas tematikave të përzgjedhura.

31 përfitues/e të programit të D&E të cilat **kanë patur procese gjyqësore kundër trafikantëve** të tyre janë informuar vazhdimisht rreth çështjeve të tyre përmes takimeve direkte me prokurorët e çështjeve. Shumica e çështjeve janë ndjekur pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Nga rastet të cilat kanë denoncuar, **18 prej tyre kanë qenë raste të reja të hyra në program** gjatë kësaj periudhe.

4 përfitues/e të D&E kanë aplikuar për ID card. Për pajisjen e përfitueseve me certifikata lindjeje familjare është bashkëpunuar me Drejtorinë e Policisë të zonave nga ku vijnë rastet.

■ Mbështetje për rastet e huaja

Në programin e organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, gjatë periudhës janar-dhjetor 2016 janë asistuar për nevojat e tyre ligjore **7 raste të huaja**, respektivisht nga Anglia, Filipine, Kongo, Nigeri dhe Moldavia. Për tre raste është përgatitur dokumentacioni për aplikim për leje qëndrimi dhe janë siguruar ato. Dy përfitues, një nga Filipine dhe tjetri nga Nigeria janë asistuar gjatë procesit të rikthimit në vendin e origjinës duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm dhe duke lehtësuar komunikimin me institucionet dhe agjencitë e tjera mbështetëse. Për këtë është bashkëpunuar me IOM dhe ONAC. Për përfituesen nga Kongo është mundësuar regjistrimi i fëmijës në gjendjen civile, shoqërim dhe asistencë në Gjykatë si dhe në institucionet e tjera si Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit, dhe UNHCR. Përfitueses i është miratuar azili, qëndrimi në Shqipëri. Për përfituesen nga Anglia është siguruar asistencë dhe përfaqësim në procesin civil për kujdestarinë e fëmijeve. Çështja është pushuar në favor të përfitueses. Gjithashtu me zgjedhjen e saj ka filluar procesi i përgatitjes së dokumentacionit për kthimin në vendin e origjinës. Për këtëpo bashkëpunohet me Ministrinë e Punëve të Brendshme, IOM dhe Ambasadën Britanike në Shqipëri.

■ Diskutime në grup - Tema ligjore

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2016 janë zhvilluar rregullisht takime në grup me përfituesit/et për të trajtuar tema të ndryshme ligjore. Këto seanca kanë shërbyer për të informuar dhe këshilluar përfitueset për tema dhe situata të ndryshme ligjore. Temat e përzgjedhura janë të lidhura me probleme që shqetësojnë në praktikë përfitueset, por edhe informuese dhe edukative për kuadrin ligjor dhe procedura të ndryshme. Temat ligjore të përzgjedhura për t’u trajtuar në seancat në grup janë si më poshtë:

- Të drejtat e njeriut duke u fokusuar tek të drejtat themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligje të tjera;
- Kuadri ligjor që rregullon fushën e luftës kundër trafikimit, në veçanti dispozitat e Kodit Penal që dënojnë trafikimin e personave;
- Tema të lira për familjen dhe të drejtën familjare (familja si koncept ligjor, martesë, zgjidhja e martesës, pjesëtimi i pasurisë pas martesës, caktimi i kujdestarisë, detyrimi ushqimor, biresimi etj);
- Sistemi i drejtësisë në Shqipëri – Njohja me sistemin gjyqësor dhe shkallët e gjykimit të çështjeve penale dhe civile, aksesit në drejtësi;
- Njohja me institucionet publike (Pushteti Qendror dhe Pushteti Vendor);
- E drejta e pronës private, pozita e femrave në raport me pronën;
- E drejta e lëvizjes së lirë;
- E drejta për t’u informuar mbi dokumente zyrtare – institucioni i Avokatit të Popullit;
- E drejta e strehimit;
- E drejta e besimit;
- Balanca punë, jetë, përkushtimi ndaj familjes dhe shëndetit;
- Aspekte ligjore që kanë të bëjnë me antidiskriminimin;
- Të drejtat e fëmijëve. Njohja me rregulloren dhe standardet e organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë” për trajtimin e fëmijëve.

■ Trajnime për punësim, kurse profesionale

Në total 26 *përfitues/ekanë ndjekur kurse profesionale*. Disa përfitues kanë ndjekur më shumë se sa një kurs, bazuar në aftësitë dhe dëshirat individuale.

■ Kurse profesionale / Trajnime profesionale

Nr	Kurse	Ofruar	Nr. i rasteve
1.	Italisht	Vullnetare D&E	11
2.	Sekretari	Qendra e formimit profesional	1
3.	Parukeri & Estetikë	Qendra e formimit profesional Sallon Privat	2
4.	Kuzhinë	Qendra e formimit profesional Qendër Private e formimit profesional	7
5.	Gjuhë Shqipe	Mesuese Private	1
8.	Kurs kompjuteri	Qendra e Edukimit D&E	20
9.	Anglisht	Vullnetare D&E Qendra e formimit profesional	12 1
10.	Kurs kitare	Qendra e Edukimit D&E	14
11.	Kurs mekanik	Qendra e formimit profesional	1
12.	Rrobaqepësi	Rrobaqepësi private	1

TABELA 17

Për të rritur aftësitë për jetën të përfitueseve, stafi i D&E ka organizuar aktivitete të ndryshme në Qendrën e Edukimit, trajnime për çështje të ndryshme, diskutime në grup, leximi i librave artistik, mësimi i materialeve shkollore si dhe i materialeve të kurseve ku ato marrin pjesë.

■ Edukim dhe shkollim

Për rastet e reja të hyra në program është bërë nga mësuesja e D&E një vlerësim për përcaktimin e nivelit arsimor të çdo përfitueseje dhe më pas është zhvilluar një plan edukativo-mësimor si pjesë e planit të riintegritit të çdo përfitueseje.

28 përfituese kanë ndjekur gjatë kësaj periudhe shkollën

Përfitueset janë ndihmuar rregullisht nga mësuesja e D&E për t'u përgatitur veçanërisht për lëndët ku ato kanë pasur boshllëqe nga e kaluara.

Të gjitha përfitueseve iu janë siguruar librat si edhe mjetet e tjera të nevojshme për një vijueshmëri sa më të mirë akademike.

Për raste të tjera të akomoduar në Qendrën e Riintegritit, të cilat nuk kanë ndjekur asnjë klasë shkollë.

D&E ka bashkëpunuar ngushtë me drejtorinë e shkollës 9- vjeçare dhe drejtorinë e shkolles se mesme ku përfitueset janë regjistruar duke u interesuar për mbarëvajtjen e tyre mësimore.

Për regjistrimin e rasteve specifike në sistemin shkollor D&E ka bashkëpunuar me MAS dhe DART

■ Ndërmjetësim me familjen

Organizata jonë është përqendruar shumë në punën që bëhet për ndërmjetësimin me familjen. Është vënë re që **përfituesit/ettë**, cilat janë mbështetur nga familjarët e tyre janë raste të cilat kanë qenë të suksesshme në gjithë procesin e riintegritit. Gjatë seancave të këshillimeve individuale apo temave që diskutohen në grup, flitet shumë për marrëdhëniet në familje, dashurinë dhe respektin mes njëri- tjetrit. Gjatë kësaj periudhe është vënë re që jo të gjithë rastet kanë patur marrëdhënie të mira me familjarët, madje ka patur raste që janë abuzuar nga pjesëtarë të familjes, gjë që ka çuar në prishjen e një marrëdhënie të mirë mes rastit dhe pjesëtarëve të familjes. Puna për të rivendosur marrëdhënie të mira me familjarët është e vështirë.

Ndodhë rastet nuk pranojnë të komunikojnë fare me familjet e tyre. Kjo ka ndodhur për arsye të ndryshme si: abuzime brenda familjes, konflikteve, mbajtja e vajzave brenda të mbyllura, moslejimi për të vazhduar shkollën, moslejimi i daljes së vajzave të tyre me shoqërinë, shkëputja e marrëdhënieve me vajzat e tyre pas një lidhjeje apo martese të dështuar.

Era vjen nga një fshat i Jugut të Shqipërisë. Ishte minorene dhe vajzë e cila kishte marrëdhënie shumë të veshtira me familjen, kryesisht me mamin e saj. Në ditet e para pasi u fut në “shelter” ajo nuk pranonte të fliste me mamanë e saj dhe pjesëtarë të tjerë të familjes. Ishte shumë e vështirë edhe për stafin për të komunikuar me familjen, pasi nuk kishim asnjë numër kontakti me to. Pas një periudhe të gjatë këshillimesh me vajzën u arrit që hapin e parë ta bënim duke vizituar familjen e saj në fshatin ku ato jetonin. Takimi ishte shumë emocionues, nuk ndaheshin nënë e bijë. Duke qenë se ishte vizita e parë, si dhe mbështetur në historinë që vajza kishte treguar, stafi u shoqërua nga përfaqësues të policisë së qytetit për realizimin e një takimi të sigurt. Takimi shkoi shumë mirë, vajza ishte shumë e mirëpritur dhe që pas atij takimi vajza ka patur kontakte të rregullta me familjen. Përveç telefonatave të zakonshme vajza ka vizituar familjen disa herë si dhe ata kane ardhur në Tirane për t’u takuar me vajzën e tyre.....

Gjendur në këtë situatë çdo menaxher rasti bën një plan së bashku me rastin, duke vënë disa qëllime dhe objektiva se si të arrihet që kjo marrëdhënie kaq e rëndësishme dhe njerëzore të përmirësohet, gjë që ka ndihmuar në tërë rrugëtimin e gjatë të riintegrit. Pas një pune të tillë janë arritur rezultate të kënaqshme. Për të arritur këtë qëllim kaq të rëndësishëm bëhen telefonata të rregullta çdo ditë me familjarët gjë që arrihet nëpërmjet thirrjeve telefonike. Një telefon, numrin e të cilit e dinë të gjithë familjarët është në dispozicion të çdo rasti.

Takime në Tiranë apo në rrethet e tyre prej nga rastet vijnë realizohen shpesh. Në këto takime menaxherët e rasteve apo dhe psikologjia bëjnë këshillime edhe me pjesëtarët e tjerë të familjes.

Përfitueset për raste festash apo ditëlindjesh shkojnë dhe festojnë në familjet e tyre në qytetin e origjinës.

Vajzat të cilat kanë probleme sigurie shoqërohen nga stafi, për takimet me familjarët në Drejtorinë e Policisë për të qenë të sigurt të dyja palët.

Organizata jonë është mbështetur nga Drejtoritë e Policivedheorganizata të tjera partnere për lehtësimin e kontakteve me familjarët në qytete të ndryshme, prej nga vajzat vijnë.

Gjatë këtij viti:

- 28 përfitues/e janë asistuar në familjet e origjinës.
- 3 raste të hyra në program gjatë kësaj periudhe janë asistuar direkt në familje.
- 10 përfituese janë bashkuar me familjet e tyre gjatë kësaj periudhe dhe vazhdojnë të ndihmohen nga D&E.

■ Aktivitetet social - kulturore

Gjatë kësaj periudhe janë organizuar disa aktivitete sociale për përfitueset. Aktivitetet janë organizuar si brenda dhe jashtë qendrës.

- Aktivitete të organizuara brenda “shelherit”
- *Diskusime grupi me tema të ndryshme*
- *Organizimi i festave të ndryshme*
- *Festimi i ditëlindjeve të përfitueseve*
- *“Workshop”kuzhine nëpërmjet të cilave përfitueset mësojnë të gatujnë receta të ndryshme*
- *Lojëra të ndryshme argëtuese, energjike*
- *Përgatitja e punëve të dorës qëndisje*
- *Mbrëmje muzikore të organizuara çdo të shtunë*
- *Leximi i librave të ndryshëm nga biblioteka e D&E*
- *Kinema në shtëpi*
- *Fitness, palestër*
- *Lojëra energjike;*
- *Lojë me letra, murlan*
- *Karaoke*
- *Këngë dhe vjersha për fëmijët në qendër*

■ Aktivitete jashtë “shelherit”

Janë organizuar një sërë aktivitete edhe jashtë strehëzës me karakter zbavitës, por dhe informues.



FIGURA 7

Gjatë muajve korrik dhe gusht, të gjitha përfitueset e Qendrës së Riintegrimit kanë frekuentuar pishinën për dy javë. Pishina është frekuentuar për disa ditë edhe nga meshkujt, përfitues të programit të D&E.

■ **Ndihmë financiare dhe afatgjatë**

- 101 rastedhe 86 fëmijë janë asistuar meshërbime në komunitet në fazën e dytë dhe të tretë të programit të riintegrimit gjatë kësaj periudhe.
- Ngakëto, 68 rastedhe 80 fëmijë janë ndihmuar në apartamente, 28 rastedhe 6 fëmijë janë mbështetur në familjet e tyre, 5 përfitues janë asistuar në vende të tjera alternative.
- 24 përfituese të reja dhe 38 fëmijë të tyre kanë hyrë në program duke u ndihmuar direkt në apartament dhe 3 përfitues e 1 fëmijë kanë hyrë në program duke u ndihmuar direkt në familje; 2 përfitues janë asistuar direkt në vend tjetër alternativ;
- 3 raste dhe 2 fëmijë kanë kaluar nga qendra për t'u mbështetur në apartament me qera dhe 10 raste dhe 1 fëmijë kanë kaluar nga qendra për t'u mbështetur në familjen e origjinës;
- D&E ka mbështetur përfituesit financiarisht me mbulimin e qerasë së apartamenteve në fazën e dytë të programit të riintegrimit, të konsideruara shumë të rëndësishme në procesin e fuqizimit të përfituesve, si dhe drejtim të riintegrimit të suksesshëm në shoqërinë shqiptare.

■ **Informacion mbi shërbimet në komunitet**

Rastet që asistohen në apartament / familje, në bazë të nevojave të tyre, janë informuar për shërbimet që ofrohen në komunitet. Janë orientuar rastet për vendodhjen e institucioneve dhe shërbimet që ofrohen nga këto institucione. Përkatësisht për shërbimet shëndetësore, shërbimet që ofrohen nga Bashkia e Tiranës, për bonus qeraje, banesa sociale, etj. Gjithashtu është dhënë informacion edhe rasteve e individëve të cilët nuk janë në programin tonë, por kërkojnë informacion në lidhje me institucione të tjera ku mund të marrin shërbime dhe ku mund t'i përfitojnë ato.

- Menaxherët e rasteve të D&E kanë ofruar mbështetje si dhe kanë orientuar përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit për të përgatitur dokumentet e nevojshme për të aplikuar për skemat e strehimit të Bashkisë së Tiranës. 8 përfitues kanë aplikuar për

programin e bonusit të qerasë ose atë të strehimit social dhe 4 prej tyre kanë përfituar bonus qeraje.

- Mjekja e D&E ka orientuar dhe informuar përfituesit e asistuar në fazën e dytë të programit në mënyrë që të marrin trajtim mjekësor pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, ku janë regjistruar të gjitha përfituesit e D&E. Disa nga përfituesit janë pajisur me Kartën e Shëndetit dhe të tjerët janë në proces.
- Përfitueset të cilat kanë kaluar nga Qendra në apartament me qera ose janë duke u mbështetur në familjen e tyre të origjinës, janë orientuar edhe për të përgatitur dokumentet që nevojiten për të përfituar ndihmën ekonomike. Organizata D&E ka lëshuar një deklaratë për çdo përfitues, i cili ka qenë pjesë e programit të riintegrit, e nevojshme për të përfituar ndihmën ekonomike nga shteti. 3 raste kanë përfituar ndihmë ekonomike gjate vitit 2016.
- Gjithashtu janë informuar rastet, që asistohen në apartament, për përgatitjen e dokumenteve për regjistrimin e fëmijëve në çerdhe.

■ Monitorimi dhe ndjekja e rasteve

Përfituesit e fazës së dytë dhe të tretë të programit të D&E janë mbështetur me të gjitha shërbimet në komunitet, të përmendura më lart, bazuar në nevojat e tyre.

101 raste janë monitoruar gjatë këtij viti

Monitorimi i përfituesve vazhdon të kryhet me anë të takimeve direkte, ashtu edhe me anë të kontakteve të rregullta me telefon.

Sesione të rregulltakëshillimijane ofruar nga psikologjia e D&E për përfituesit në program, të cilët janë aktualisht në fazën e dytë të riintegrit. Kontakte të rregullta, përfituesit e fazës së dytë të programit të riintegrit kanë edhe mëmenaxherët e rasteve. Gjatë kësaj periudhe stafi ka monitoruar dhe ka bërë takime direkte me përfitues/e të cilat jetojnë në qytetet e tyre të origjinës si Durrësi, Berati, Kucove, Fier, Vlorë, Elbasan, Korçë, Pogradec, Lezhë dhe Shkodër.

2.2 Kontributi në kthimin e asistuar të viktimave të trafikimit, apo viktime të dhunës në familje

■ Kthimi i rasteve të huaja në vendin e origjinës

Gjatë kësaj periudhe D&E ka mbështetur *shtatë raste të huaja* në programin e riintegrit. Dy përfituese, një nga Filipinet dhe një nga Nigeria, që me vullnetin e tyre vendosën të kthehen në vendin e origjinës, janë asistuar gjatë procesit të rikthimit duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm dhe duke lehtësuar komunikimin me institucionet dhe agjencitë e tjera mbështetëse. Për kthimin e tyre D&E është mbështetur nga zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, dhe nga IOM për lehtësimin financiar. Tre raste janë në proces për kthimin e tyre në vendin e origjinës, një prej përfitueseve me shtetësi angleze dhe dy me shtetësi moldave. Dy raste të tjera janë duke u asistuar në program.

■ Kthimi i rasteve shqiptare në vendin e tyre, Shqipëri

Gjatë kësaj periudhe D&E është kontaktuar nga organizata “Salvation Army” në UK për kthimin e një rasti, i vlerësuar sipas tyre si viktimë trafikimi. Pas njoftimit të Autoritetit Përgjegjës për kthimin e këtij rasti dhe lehtësirave të krijuara për kalimin e saj rasti u prit në aeroport dhe u akomodua në Qendër.

2 raste, viktimat të dhunës në familje dhe 4 fëmijë të tyre janë kthyer nga Gjermania gjatë këtij viti dhe janë mbështetur në programin e riintegrit të D&E. Rastet janë asistuar në apartament, mbështetur financiarisht nga D&E. Shërbimet për këto raste janë ofruar bazuar në nevojat e tyre dhe të fëmijëve të tyre.

2.3 Asistencë direkte për meshkuj viktimat të trafikimit

Gjatë kësaj periudhe D&E ka ndihmuar 21 meshkuj viktimat/viktima të mundshme trafikimi apo viktimat të abuzimit seksual nga të cilët 6 meshkuj janë raste të reja të referuar pranë programit riintegruar të D&E.

■ Burimi i referimit për rastet e reja meshkuj të asistuar gjatë janar – dhjetor 2016:

Burimet e referimeve	Nr. i rasteve
IOM	1
ARSIS	1
Aleanca LGBT	1
Shtëpia e fëmijes “Zyber Hallulli”	1
Vetereferuar	2
Total	6

TABELA NR 18

Në bashkëpunim me menaxherin e rasteve të D&E, është ndërtuar një plan riintegrimi për secilin rast dhe janë mbështetur për të arritur objektivat evëna në plan.

Strehimi mbetet një ndër nevojat më bazike të meshkujve viktimat trafikimi apo viktimat të mundshme trafikimi të asistuar deri tani. Ashtu sikurse duket që varfëria vazhdon të mbetet një ndër faktorët kryesorë që meshkujt e rinj të moshës 15-22 vjeç të bien pre e shfrytëzimeve të llojeve të ndryshme.

Punësimi të qëndrueshëm të rasteve i është dhënë një rëndësi e veçantë gjatë procesit të riintegrit. Gjatë këtij viti janë ndihmuar me ndërmjetësim për punësim apo fuqizim ekonomik. Një ndër sfidat kryesore që mbetet lidhur me punësimin është fakti që shumica e rasteve kanë nivele të ulta edukimi dhe përvojë shumë të pakët pune. Kjo e bën procesin e riintegrit dhe të qëndrueshmërisë në punë të vështirë për disa përfitues. Shpesh ata duhet të provojnë 2-3 punë të ndryshme derisa të gjejnë veten në një punë të caktuar. Gjithashtu tregu aktual i punës është relativisht i varfër për këtë grupmoshë dhe i vetmi profil pune që gjen masivisht në njoftimet e punësimit, është puna si banakier apo kamarier.

Gjithashtu një fokus i rëndësishëm i është dhënë edhe kurseve profesionale. Gjatë vitit 2016 kanë marrë pjesë në takimet e “Këshillim drejt punësimit”, 3 raste. Një fokus tjetër i rëndësishëm janë kurset profesionale të gjuhëve të huaja. Kjo është parë edhe në fokusin e mëtejshëm të punësimit, duke qënë se një ndër tregjet kryesore të punësimit për të rinj janë “call center”. Nga përfituesit e futur së fundmi në program 2 prej tyre po ndjekin kurse të anglishtes dhe të italishtes. Katër përfitues kanë ndjekur shkollën gjatë kësaj periudhe.

Rastet janë mbështetur me këshillimpisiko-social, ndihmë ligjore, asistencë mjekësore, mbështetje për të gjetur një punë, mbështetje financiarepërpagesën eapartmentitme qira; trajnim për të rritur aftësitë për jetën; ofrim informacionidhendërmjetësim për marrjen e shërbimeve të ofruarangaofruesite shërbimeve të ndryshmenë komunitet, monitorimdhendjekje, etj. Psikologia e D&Eka ofruarseanca të rregulltakëshillimiindividualpër të gjithëpërfituesitmeshkuj nëprogram.

2.4 Rritja e përpjekjeve për identifikimin e VeT

Gjatë kësaj periudhe stafi i D&E ka marrë pjesë në tavolina multidisiplinare të organizuara nga Njësitë Bashkiake nr. 3, 5, 8, 9 dhe 11.

Si pjesë e nismës “Për fëmijët në situatë rruge” të iniciuar nga Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, D&E ka asistuar Njësinë Administrative nr.2 dhe nr.3 me dalje në terren 3-4 herë në javë. Puna zhvillohet në terren në bazë të një kalendari i cili hartohet nga Bashkia e Tiranës. Grupi i terrenit përbehet nga 1 punonjës i NJMF përkatëse, nga punonjësi i D&E dhe në raste të veçanta asiston dhe një punonjës policie. Zonat ku stafi është përqëndruar kanë qënë: xhamia e “Et’hem Beut“, “Pallati i Kulturës“, “Piazza“, “Rr. e Elbasanit“ dhe “7-xhuxhat“. Gjatë kësaj kohe janë identifikuar rreth 38 raste të fëmijëve në situatë rruge. Gjatë punës në terren janë vënë re disa raste të përsëritura dhe në një rast është njoftuar edhe policia. Kryesisht në rastet e identifikuara është vënë re shfrytëzimi i të miturve për lypje ndërsa në një rast i mituri shfrytëzohej për punë nga babai. Përsa i perket moshës së fëmijëve në situatë rruge ajo varion nga moshë 1 vjeç – 15 vjeç dhe shumica e tyre janë femra.

Rritja e përpjekjeve për fuqizimin ekonomik të viktimave të trafikimit

■ Këshillim dhe mbështetje për punësimin e përfitueseve

Gjatë periudhës janar-dhjetor 48 përfitues/e janë mbështetur dhe kanë qënë në marrëdhënie pune, të punësuar si: kuzhinierë, ndihmës kuzhinierë, pjatatarëse në restorant, pastruese, ndihmës parukierë në sallon parukerie, operatore në call center, banakierë, pasticierë, kamarierë, punonjës mobilerie, punonjësë marketi, shitese peshku, etj.

Stafi i D&E vazhdon të orientojë përfituesit të zgjedhin profesionet të kërkuar në tregun e punës, duke u përshtatur natyrisht në çdo rast me aftësitë e tyre personale.

Në janar 2016 është krijuar grupi i ri me 15 përfitues të programit të riintegrit të D&E të përfshirë në ciklin këshillues "Këshillim për punësim" dhe zgjati deri në dhjetor 2016.

Qëllimi i këtij cikli këshillues ishte për t'i ndihmuar përfituesit për të rritur aftësitë e tyre në gjetjen dhe mbajtjen e një pune. Lehtësuesi/trajneri i ciklit këshillues ka punuar me grupet përkatëse për të krijuar ekipe të konsoliduara dhe për të identifikuar pikat e forta personale të secilit përfitues, duke synuar në afat të gjatë për të rritur aftësitë e tyre në gjetjen dhe mbajtjen e një pune; iniciativat inkurajuese dhe aftësitë hulumtuese të pjesëmarrësve; zhvillimi i kompetencave sociale të grupit; marrja e njohurive dhe përgatitje për stazhe afatshkurtra. Pjesëmarrësit në trajnim janë njohur me profesione dhe biznese të reja, duke u përgatitur për një përfshirje të mundshme në praktika pranë këtyre bizneseve. Gjatë takimeve në grup, pjesëmarrësit patën mundësinë për të shkëmbyer përvojën me njeri-tjetrin, ndërkohë që janë zhvilluar dhe "Planet individuale të zhvillimit". Takimet janë organizuar dy herë në javë në ambientet e Qendrës së Edukimit.

D&E vazhdon të ketë kontakte të rregullta me Zyrën Rajonale të Punësimit dhe të gjithë përfituesit që janë tashmë gati për të punuar janë regjistruar pranë këtij institucioni si punëkërkuar.

■ *Mbështetja e përfituesve për hapjen e bizneseve të vogla*

Gjatë kësaj periudhe **5 përfitues të D&E kanë menaxhuar bizneset e tyre**. Përfituesit janë monitoruar rregullisht dhe u është siguruar mbështetje teknike sipas nevojave të tyre.

■ *Pilotimi i programit të "internship-it" me kompanitë e biznesit*

Gjatë kësaj periudhe **5 përfitues kanë qenë të përfshirë në programet e "internship-it"**. Tre përfitues kanë punuar si ndihmëskuzhinierë në tre restorante të ndryshme, 1 përfitues si ndihmës parukier në një sallon bukuri dhe 1 rast punon në një dyqan rrobaqepësie.

2.5 Avancimi i bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe me institucionet shtetërore lokale

D&E bashkëpunon me shumë institucione shtetërore, organizata joqeveritare, organizata ndërkombëtare, kompani biznesi, institucione fetare, për programin e riintegrit për viktimat e trafikimit.

Partnership me institucione jo-shtetërore, OJF, institucione fetare:

- Anëtarët e Koalicionit Komëtar të Strehëzave Anti-trafik
- SHKBSH;
- Krahët e Shqiponjës;
- ARSIS;
- Terre des Homes
- CARITAS Albania;
- Papa Giovanni XXIII
- Mary Ward Loreto Foundation
- Qendra ligjore TLAS dhe QNLQ;
- Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”;
- SHKEJ;
- Qendra për fëmijët në situatë rruge / Save the children;

■ Bashkëpunimi me kompanitë e biznesit

Gjatë vitit 2016 D&E ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtësisht me një sërë kompanish biznesi. Seleksionimi i tyre bëhet në mënyrë të kujdesshme dhe në partneritet të plotë me Zyrat Rajonale të Punësimit. Ky bashkëpunim është fokusuar në dy drejtime kryesore:

- Në punësimin e përfituesve të programit sipas profileve specifike të formimit të tyre profesional ose eksperiencës së mëparshme të punës.

Çdo vit bashkëpunohet minimalisht me 50 – 60 kompani biznesi për këtë qëllim.

- Zbatimi i programit të “internship-it“, i cili vazhdon të jetë një nga format me efektive për të ndihmuar përfitueset e programit të trajnohen në vendin e punës, ndërkohë që paguhen për punën e bërë dhe përfshihen në skemen e sigurimeve shoqërore sipas ligjeve në fuqi. Gjatë vitit 2016 është bashkëpunuar specifikisht për këtë program me 5 kompani biznesi. Kompanitë e biznesit me të cilat D&E ka bashkëpunuar në këtë drejtim kanë qenë kryesisht restorante, atelie rrobaqepësie dhe sallone parukerie. Periudha e përfshirjes së përfituesve në këtë lloj programi është minimalisht 3 muajore. Pas përfundimit të periudhës së “internship-it“ përfituesit janë punësuar në të njëjtin profil duke pasur si avantazh eksperiencën e përfituar.

Aspekti tjetër i bashkëpunimit të D&E me kompanitë e biznesit ka qenë edhe për të gjeneruar të ardhura për ofrimin e shërbimeve riintegruese për përfitueset e programit. Gjatë vitit 2016 është organizuar nga D&E një mbrëmje bamirësie për realizimin me sukses të së cilës është bashkëpunuar ngushtësisht me disa kompani biznesi, të cilat kanë dhuruar artikuj ose shërbime të ndryshme në mbështetje të kauzës. Kompanitë me të cilat është bashkëpunuar kanë qenë kryesisht kompani serioze që operojnë prej vitesh në Shqipëri në fushën e shërbimeve të hotelerisë, restoranteve, prodhimit të pijeve joalkoolike, shërbimet e përkujdesjes, studio grafike etj. Specifikisht është bashkëpunuar me 20 biznese për këtë aktivitet.

■ **Bashkëpunimi me institucionet shtetërore për iniciativa të ndryshme**

D&E ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik:

- Takime të organizuara në kuadër të MKR;
- Takime të organizuara nga Autoriteti Përgjegjës për diskutimin e rasteve të vështira;
- Takime të organizuara në kuadër të rishikimit të Procedurave Standarte të Veprimit për identifikimin dhe Referimin e VT dhe VMT;

D&E ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet e organizuara nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe Agjensia për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve:

- Takime konsultuese mbi mbrojtjen e fëmijëve në situata rruge;
- Mbledhja e katërt e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;

D&E ka marrë pjesë në disa aktivitete të organizuara nga agjenci të ndryshme partnere, si dhe janë përgatitur disa materiale me sugjerime për përmirësimin e kuadrit ligjor. Më konkretisht janë dhënë komente dhe sugjerime për projektligjet e mëposhtme:

- Draftprojektligji i ri për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve;
- Projektligji për ndërmarrjet sociale;
- Procesi i hartimit të axhendës kombëtare për të drejtat e femijeve 2016-2020;
- Projektligjin e strehimit social;
- Projektligjin për shërbimet shoqërore;

Bashkëpunimi me institucione shtetërore:

- Ministria e punëve të Brendshme/Zyra e Koordinatorit Kombëtar anti-trafik;
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Anëtarët e Mekanizmit Kombëtar të referimit;
- Këshilli i Qarkut Tiranë;
- Bashkia Tiranë;
- Shërbimi Social Shtetëror/Zyrat Rajonale të shërbimit Social;
- D&E ka firmosur një marrëveshje granti për herë të parë këtë vit me Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;
- Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
- Qendra e Formimit Profesional;
- Njësitë për Mbrojtjen e Femijeve;
- Zyrat Rajonale të Punësimit;
- Drejtoria Rajonale e Arsimit.

- Shqyrtimi i projektbuxhetit për vitin 2017.

2.6 Aktivitete ndërgjegjëse për trafikimin

■ Aktivitet në kuadër të “Planit të Mobilizimit” #UnëMbrojFëmijët

Në kuadër të “Planit Kombëtar të Mobilizimit” [#UnëMbrojFëmijët](#), organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" zhvilloi 4 takime ndërgjegjëse mbi dhunën seksuale me nxënësit e “Shkollës së Mesme Mullet”, Tiranë, në shkollën e mesme jo publike "Rogacionistët", Lezhë; në gjimnazin "Myrteza Kepi" Kuçovë; në Qendrën Rinore të Tiranës me të rinjtë nga komuniteti dhe universiteti.

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” mori pjesë në “Panairin e të Drejtave”, aktivitet organizuar në kuadër të përmbylljes së “Planit Kombëtar të Mobilizimit” [#UnëMbrojFëmijët](#). Aty u shpërndanë materiale ndërgjegjëse dhe u shitën disa nga punimet e përfituesve.



FIGURA 8



FIGURA 9

■ Panairi i familjes

Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" u bë pjesë e “Panairit të Familjes” mbajtur më datë 14 Maj nga MMSR dhe Agjensia e Mbrojtjes së Fëmijëve.



FIGURA 10

FIGURA 11

■ Aktivitete në kuadër të muajit kundër trafikimit në persona

Sesione informuese në shkolla

Gjatë muajit tetor, në kuadër të muajit kundër trafikimit në persona, organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” ka organizuar sesione informuese në 6 shkolla të Tiranës. Shkollat e përzgjedhura ishin: shkollat e mesme "Ismail Qemali" dhe "Isa Boletini", shkollat 9-vjecare "Lasgush Poradeci", "Bajram Curri", "Farke e Vogel" dhe "Kamza e Re". Shumica e këtyre shkollave janë vendosur në zona informative, në periferi të Tiranës.

Gjatë këtyre sesioneve, nxënësit u informuan për çështjet e trafikimit, si: çfarë është trafikimi; mënyrat e trafikimit; profili i viktimës; treguesit për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit dhe referimin e viktimave të trafikimit. Në çdo shkollë ishin rreth 40 nxënës që morën pjesë në këto sesione.



FIGURA 12



FIGURA 13

Organizimi i konkursit mes shkollave

Më 11 dhe 12 tetor janë realizuar dy sesione trajnuese me nxënësit e përzgjedhur nga gjashtë shkollat e Tiranës, të cilët morën pjesë më pas në një konkurs lidhur me çështjet e trafikimit. 5 nxënës nga secila shkollë morën pjesë në këtë aktivitet. Më 17 tetor u organizua konkursi mes këtyre shkollave ku u shpallën tre fitues.

Këto aktivitete u organizuan në bashkëpunim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, Prefektura e Qarkut Tiranë, Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Qendrën Rinore Tiranë.



FIGURA 14



FIGURA 16

FIGURA 15



FIGURA 17

Sesione informuese në komunitet

Gjatë muajit tetor janë realizuar gjithashtu tre aktivitete me vajza dhe gra në Lezhë, Kukës dhe Dibër. Në këto sesione informuese morën pjesë vajza dhe gra në nevojë dhe gjithashtu punonjës të administratës lokale. Në këto aktivitete pjesëmarrësit u informuan për çështjet e trafikimit, format e ndryshme të shfrytëzimit dhe gjithashtu në lidhje me sistemin e mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave të trafikimit në Shqipëri. Më 6 tetor seanca informuese në lidhje me çështjet e trafikimit është realizuar në Lezhë me pjesëmarrjen e 12 grave dhe vajzave në nevojë nga komuniteti rom dhe egjiptian. Ndërsa më 10 tetor, një tjetër aktivitet u realizua me pjesëmarrjen e 14 grave dhe vajzave nga administrata lokale dhe nga komuniteti. Më 13 tetor sesioni i informimit u realizua në Dibër. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin 17 vajza dhe gra në nevojë.



FIGURA 18



FIGURA 19

Ekspozita me piktura

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” mori pjesë me punime të vajzave dhe grave viktime të trafikimit në ekspozitën kombëtare që Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik organizoi gjatë muajit tetor. Kjo ekspozitë ishte me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare dhe përfituesve të qendrave. Ekspozita qëndroi hapur dy ditë dhe në fund të saj u shpërndanë disa çmime.



FIGURA 20



FIGURA 21



FIGURA 22



FIGURA 23

■ **Aktivitetet në kuadër të projektit “Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushatë antitrafikimi”**

Që prej muajit qershor 2016, “Të Ndryshëm & Të Barabartë” po zbaton projektin “*Fuqizimi i të rinjve në rrezik për të zhvilluar fushatë ndërgjegjësuese antitrafikimi*”. E veçantë e këtij projekti është se ai bazohet në qasjen “*Të rinjtë për të rinjtë*”, ku fillimisht trajnohen një grup prej 60 të rinjsh për çështje, të cilat lidhen me trafikimin dhe pastaj ata trajnojnë bashkëmoshatarët tyre në qarqet ku jetojnë. Objektivi kryesor i këtij projekti është rritja e kapaciteteve të një grupi të vogël të të rinjve vulnerabël për të dizenuar, zhvilluar dhe prezantuar një fushatë ndërgjegjësimi kundër trafikimit, duke i fuqizuar ata si agjentë të ndryshimit dhe duke rritur gjithashtu dijet e komunitetit në lidhje me trafikimin. Projekti po zbatohet në qarqet e Dibrës, Kuksit, Lezhës dhe Tiranës. Në secilin prej qarqeve është caktuar një lehtësues lokal, i cili ndihmon dhe koordinon grupin e të rinjve në atë qark. Në secilin qark janë përzgjedhur 15 të rinj, të cilët vijnë nga kontekste të disavantazuara, me familje me nivel socio-ekonomik të ulët, zona të varfra ku ka pak shërbime apo me incidencë të lartë të trafikimit. Secili grup prej 15 të rinjsh (në total 60 të

rinj në 4 qarqet e Shqipërisë) janë trajnuar dhe do të trajnohen në çështje që lidhen me trafikimin, në hartimin dhe dizenjimin e fushatave ndërgjegjësuese antitrafik, në të folurin në publik dhe në njohuri kompjuterike që mund të ndihmojnë në zbatimin e fushatës.

Në kuadër të këtij projekti me **7 tetor 2016, u zhvillua një “workshop“ me pjesëmarrës aktorë të Komiteteve Rajonale Antitrafik të të 4-ta qarqeve.**

Gjatë periudhës nëntor – dhjetor 2016 janë zhvilluar nga 2 trajnime për secilin prej qarqeve, në total 8 trajnime, me të rinjtë e fushatës. Dita e parë e trajnimeve është përqendruar në çështjet e trafikimit të personave, ndërsa dita e dytë e trajnimit ka qenë e fokusuar në dizenjimin dhe zbatimin e fushatave ndërgjegjësuese në komunitet. Trajnimet janë bazuar në një metodologji ndërvepruese, ku të rinjtë ftoheshin vazhdimisht për pjesëmarrje sa më aktive në trajnim, duke ndërthurur pjesën teorike të trajnimit me shembuj të shumtë, punë të ndryshme në grup, studime rastesh, lojëra të ndryshme etj. Gjithashtu gjatë ditës së dytë të trajnimit të rinjtë janë përqendruar në zhvillimin praktik të fushatës duke ndërtuar një model të fushatës së tyre në qarkun e tyre dhe duke përzgjedhur aktivitetet dhe zonat specifike të qarkut ku do zhvillohen aktivitetet.

Këta 60 të rinj të mirëtrajnuar në lidhje me çështjet e trafikimit, hartimit e dizenjimit të fushatave dhe të folurit në publik, do të trajnojnë të rinj të tjerë në Qarkun e tyre gjatë periudhës mars – maj 2017. Në total është parashikuar që këta të rinj të kryejnë më shumë se 40 aktivitete ndërgjegjësuese, pra më shumë se 10 aktivitete për secilin qark. Më pas këta të rinj do zhvillojnë fushata me qëllim ndërgjegjësimin në lidhje me fenomenin e trafikimit në komunitetin e tyre, duke përfshirë edhe përdorimin e mediave sociale, mediave elektronike dhe atyre të shkruara në dobi të ndërgjegjësimit në lidhje me trafikimin. Gjithashtu, është parashikuar prodhimi dhe shpërndarja e 600 posterave dhe 8000 fletëpalosjeve që do shërbejnë si materiale ndërgjegjësuese gjatë takimeve në komunitet. Nga ky projekt pritet të ndërgjegjësohen 15 000 të rinj në të katër qarqet.



FIGURA 24



FIGURA 25



FIGURA 26



FIGURA 27

■ Fushata UN.GIFT BOX

“UN GIFT BOX” është fushatë për ndërgjegjësimin publik mbi çështjen e trafikimit të personave dhe vjen në Shqipëri nga bashkëpunimi i rrjetit URAT me “Stop the Traffic”, “UN GIFT” dhe Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik. “UN Gift Box” u hap për herë të parë në Qytetin e Durrësit me datën 25 korrik 2016 dhe qëndroi e hapur për 8 (tetë) ditë, në këtë qytet përfshirë këtu edhe datën 30 korrik e cila përkon me Ditën Ndërkombëtare Kundër Trafikimit të Personave, ditë në të cilën u organizua edhe ceremonia zyrtare e hapjes së fushatës verore nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik në bashkëpunim me URAT.

Kutia “UN.Gift” ofroi për qytetarët informacione nëpërmjet materialeve ndërgjegjëse mbi trafikimin në njerëz. Kutia qëndroi pranë Bashkisë së Durrësit përgjatë datave 26 korrik - 2 gusht, duke u vënë në dispozicion të të gjithë qytetarëve në oraret 09.00-12.00 paradite, 16.00-21.00 pasdite. 3805 qytetarë vizituan kutinë dhe morën informacion mbi fenomenin e trafikimit si dhe ku të kërkojnë ndihmë në rast nevojë.

■ Trajnimi i vullnetarëve Durrës

Më datën 25 korrik, në Durrës, u organizua trajnimi i vullnetarëve të fushatës sensibilizuese kundër trafikimit në njerëz “UN.GIFT BOX”.

22 vullnetare nga Durrësi, Tirana dhe Lushnja u trajnuan dhe më pas kontribuan gjatë gjithë ditëve të zhvillimit të fushatës në Durrës.

UNGIFT BOX në Sarandë

Fushata UN.GIFT BOX u zhvillua në Sarandë gjatë periudhës 3 – 10 shtator ku vizituan kutinë dhe u ndërgjegjësuam për trafikimin në njerëz 3000 qytetarë.

■ Trajnimi i vullnetarëve Sarandë

Në datën 2 shtator, në Sarandë, u organizua trajnimi i vullnetarëve të fushatës sensibilizuese kundër trafikimit në njerëz "UN.GIFT BOX" 10 vullnetarë të pranishëm nga qyteti i Sarandës, si dhe qytete të tjera kontribuan më pas për t'iu dhënë informacion qytetarëve gjatë gjithë ditëve të fushatës.

UN.GIFT BOX në Tiranë

Ceremonia hapëse e kësaj fushate sensibilizuese dhe parandaluese u bë në datën 3 tetor në Tiranë, duke filluar me marshimin përpara Piramidës, në orën 10.00 dhe duke lëvizur në drejtim të kutisë "UN.Gift", që ndodhej e pozicionuar në "Parkun Rinia", për hapjen zyrtare të saj në orën 11.00.

Të pranishëm ishin Ministri i Punëve të Brendshme Z.Saimir Tahiri, Zv Ministre e Punëve të Brendshme Znj. Elona Gjebrea, Prefekti i Qarkut Tiranë Z.Sadi Vorpsi, Zv. Ministre e Arsimit dhe Shkencës Znj.Nora Malaj, organizata pjesë të rrjetit URAT dhe të ftuar të tjerë. Kutia "UN.GIFT" qëndroi e hapur në Tiranë për 6 ditë dhe u vizitua nga 3127 qytetarë.



FIGURA 28



FIGURA 29

■ Trajnimi i vullnetarëve në Tiranë

Me datën 1 tetor u realizua trajnimi i vullnetarëve në Tiranë ku morën pjesë 30 të rinj të cilët kontribuan më pas gjatë gjithë fushatës "UN.GIFT BOX" në Tiranë



FIGURA 30



FIGURA 31

“UN.GIFT BOX” Shkodër

Fushata “UN.GIFT BOX” u hap në Shkodër në datën 25 tetor dhe qëndroi e hapur për 7 ditë, ku u vizitua nga 6400 qytetarë, të cilët u ndërgjegjësuan për trafikimin në njerëz, si dhe ku të kërkojnë ndihmë apo të raportojnë rastet e trafikimit.



FIGURA 32



FIGURA 33

■ Trajnimi i vullnetarëve në Shkodër

Trajnimi i vullnetarëve në Shkodër u realizua në datën 24 tetor dhe morën pjesë 50 vullnetarë, të cilët më pas u angazhuan në informimin e qytetarëve që vizituan kutinë.

2.7 Aktivitete për parandalimin e dhunës seksuale dhe trafikimit

“Universiteti i Bedfordshire” në UK, mbështetur nga “Council of Europe” dhe “OAK Foundation”, po zbaton projektin “Our Voices”(2013-2016). Ky projekt european, ka për qëllim të promovojë përfshirjen e të rinjve në përpjekjet për parandalimin e dhunës seksuale në Evropë, bazuar në idetë dhe eksperiencën e këshilluesve të rinj që vijnë nga eksperiencia të ndryshme.

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” është një nga organizatat e rajonit, e ftuar të bëhet pjesë e projektit dhe në vitin 2014 u përfshi me mbajtjen e tre konsultimeve me këshilluesit e rinj. Të rinjtë e përfshirë, kanë qenë të ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të dhunës seksuale, dhe janë përfitues të organizatës sonë.

15 takime ndërgjegjësuese me të rinjtë janë mbajtur në kuadër të këtij projekti. Takimet mbi parandalimin e dhunës seksuale u mbajtën në Tiranë, Lezhë dhe Berat. Takimet u zhvilluan në universitete, në shkolla të mesme, në qendra rinore dhe qendra rinore të kishës.

Gjatë aktiviteteve krahas informacionit me pjesëmarrësit u nda dhe një video ndërgjegjësuese përgatitur nga përfituesit e organizatës. Një poster i përgatitur gjithashtu nga përfituesit u shpërnda në shumë shkolla dhe vende që frekuentohen nga të rinjtë.



FIGURA 34



FIGURA 35




FIGURA 36



FIGURA 37

3. Trajnime dhe prezantime të ofruara nga D&E

D&E ofroi trajnim 1-ditor me psikologë, zv.drejtorë dhe drejtorë të shkollave të mesme të qytetit të Lezhës, Shkodrës, etj me titull **“Roli i psikologut në parandalimin e trafikimit dhe kuadri ligjor”**.Trajnimi u organizua në ambientet e Drejtorisë Arsimore në qytetin e Lezhës.

Trajnim ofruar për gratë police lidhur me identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Trajnim mbi “Mentorimin” organizuar nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, ofruar për stafin e D&E, vullnetarët dhe studentët.

4. Pjesëmarrja e stafit në trajnime

- Trajnim mbi **“Komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun”**, organizuar nga “ERSTE Foundation”;
- Trajnim mbi **rritjen e fondeve“Komunikimi, Komuniteti, Strategjia”** organizuar nga “ERSTE Foundation”;
- Trajnim mbi **“Menaxhimi i projekteve për angazhimin e komunitetit: Qasje të reja për bashkë-krijimin e një misioni, vizioni dhe plani duke përdorur inteligjencën kolektive”**, organizuar nga “ERSTE Foundation”;
- Trainim mbi **“Shkrimi i gazetarisë. Si mund të tregoni historitë dhe pozitën e organizatës suaj në media”**, organizuar nga “ERSTE Foundation”;
- Trainim mbi **“Eksplorimi i potencialit të pashfrytëzuar të financimit të BE-së, një qasje praktike”**, organizuar nga “ERSTE Foundation”;
- Trajnim mbi **“Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërkulturor”**, organizuar nga “ERSTE Foundation”;
- Trajnim mbi **“Supervizimi”** ofruar nga TdH;
- Pjesëmarrje në trajnimin **“Fuqizimi i strukturave shtetërore lokale në mbrojtje të viktimave të trafikimit në Shqipëri”** organizuar nga “Caritas Shqiptar”;
- Pjesëmarrje në trajnimin **“Rezoluta 1325. Te drejtat e grave, nga koncepti në realitetin Shqiptar”**,organizuar nga shoqata e grave me probleme sociale në bashkëpunim me organizatën suedeze “Operation 1325”;
- Projekti “LevizAlbania” në bashkëpunim me “Partneret Shqiptarë për Ndryshim dhe Zhvillim” trajnim 2 ditor **“Mobilizimi i Komunitetit”**;
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga OSBE të zhvilluar në Vicenza-Italy në datat 14-18 nëntor 2016. Trajnimi kishte për qëllimin organizimin e **“Trajnimit të parë simulues për çështjet e luftës kundër trafikimit nëpërmjet rrugëve migratore”**. Në trajnim morën pjesë përfaqësues të agjencive të ndryshme shtetërore dhe joshtetërore kryesisht OJF nga 31 vende të ndryshme anëtare të OSBE-së.
- Trajnim mbi **“Traumën dhe çështje të lidhura me të”** organizuar nga “Te Ndryshëm & Të Barabartë dhe ofruar nga ekspertja Ivana Slavcovic. Trainimi ishte 3-ditor dhe morën pjesë gjithë stafi i D&E.
- Pjesëmarrje nëKonferencën Ndërkombëtare mbi **"Hetimin dhe ndjekjen penale të trafikimit të qenieve njerëzore”** organizuar nga Medaile Trust në Angli. Konferenca u

organizua në Bled, Slloveni në datat 19- 20 korrik. Ky takim kishte për qëllim të jepte një qasje ndërkombëtare mbi çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për shkëmbimin e përvojave mes organizatave dhe aktorëve të përfshirë.

- Pjesëmarrje në **“Asamblenë II-të të RENATE mbi çështje të trafikimit”**, organizuar nga RENATE në 6-12 nëntor 2016 në Romë.
- Pjesëmarrje në trajnimin: **“Advokaci, lobing dhe fushata”** organizuar nga RENATE, mars 2016, Hungari
- Trajnimi i vullnetarëve dhe një pjese të stafit për fushatën sensibilizuese kundër trafikimit të qenieve njerëzore **“UN GIFT BOX Campaign”**, mundësuar nga rrjeti URAT.

5. Koordinime me aktorë të tjerë kundër trafikimit

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga ARSIS për organizimin e një fushate advokimi **“Mbi prokurimin me fonde publike të ofrimit të shërbimeve sociale”** nga organizata të **Shoqërisë Civile** në Shqipëri.
- Pjesëmarrje në takimin konsultues mbi **“Projektligjin e strehimit social”**, organizuar nga **Ministria e Zhvillimit Urban**. Në takim u prezantua projektligji i ri dhe u dhanë rekomandime nga pjesëmarrësit përfshirë edhe sugjerimet tona, të dërguara paraprakisht edhe me shkrim.
- Pjesëmarrje në **“Tryezën e Rrumbullakët”** me temë **“Diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga studimi për ndëshkueshmërinë e veprave penale të korrupsionit në sektorin publik”**, organizuar nga **Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH)**.
- Pjesëmarrja në aktivitete për antidiskriminimin organizuar nga **Këshilli i Evropës** në kuadër të programit të përbashkët të BE/KiE **“Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”**. Në këto aktivitete është diskutuar për mekanizmat e ngritur për luftën kundër diskriminimit dhe janë dhënë opinione dhe mendime për përmirësimin e bazës ligjore dhe të instrumentave kundër diskriminimit.
- Pjesëmarrje në seancën dëgjimore në **“Komisionin e Punës në Kuvend”**, për dhënien e mendimeve për projektligjin për shërbimet shoqërore. Materiali i dërguar paraprakisht me shkrim u prezantua në emër të **D&E** gjatë seancës dëgjimore.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë **“Nisma ligjvënëse popullore në RSH”** organizuar nga **Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare**. Në këtë aktivitet u prezantua iniciativa e QNL për projektligjin **“Për nismën ligjvënëse popullore në Republikën e Shqipërisë”** dhe u diskutua për risitë që sjell kjo nismë për demokracinë e drejtpërdrejtë.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e Avokatit të Popullit për prezantimin e raportit të Komitetit të CEDAW.
- Pjesëmarrje në seancën dëgjimore të zhvilluar nga **“Komisioni për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë”**, për shqyrtimin e projektbuxhetit për vitin 2017, konkretisht për ministritë e linjës së këtij komisioni, MMSR dhe MSH.
- Pjesëmarrje në ceremoninë e nënshkrimit të **“Marrëveshjes së bashkëpunimit”** me **Avokatin e Popullit** dhe koalicionit **“Drejtësi për të gjithë”**. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e **Avokatit të Popullit**. Marrëveshja ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit të

koalicionit të organizatave të SHC “**Drejtësi për të gjithë**” dhe institucionit të **Avokatit të Popullit** për të lobuar dhe punuar sëbashku për përshtetimin e reformës në drejtësi.

- Pjesëmarrje në konferencën për shtyp me temë “**Respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptar për vitin 2016**” organizuar nga **Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH)**.
- Pjesëmarrje në konferencën “**Inkurajimi i një mjedisi mundësues dhe mbështetës për zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri**” organizuar nga zyra e projektit TACSO në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, zhvilluar më datë 13 dhjetor 2016 tek hotel Tirana International. Kjo konferencë kishte për qëllim diskutimin e çështjeve më problematike lidhur me detyrimet ligjore dhe fiskale të OSHC-ve dhe ofrimin e rekomandime për përmirësimet përkatëse në të ardhmen me qëllim krijimin e një mjedisi fiskal të thjeshtë, të qartë dhe të favorshëm për veprimtarinë e OSHC-ve në Shqipëri.
- Pjesëmarrje në disa takime të koalicionit “**Drejtësi për të gjithë**”, të organizuara nga USAID gjatë muajit dhjetor në kuadër të veprimeve lobuese për nxitjen dhe përshtetimin e reformës në drejtësi, përfshirë edhe leximin e një deklarate publike në emër të koalicionit “**Drejtësi për të gjithë**”, të prezantuar në ambientet e Hotel Tirana International më datë 13.12.2016.

D&E merr STATUSIN E VECANTË KONSULTATIV me UN (ECOSOC)

Statusi Konsultativ i Këshillit Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) është statusi më i lartë dhënë nga Kombet e Bashkuara për organizatat joqeveritare, duke i lejuar ato të marrin pjesë në punën e Kombeve të Bashkuara. Këtë vit ky status i është akorduar edhe D&E, e cila bazuar në këtë status është organizatë këshilltare për çështjet e trafikimit për UN në New York, Genevë dhe Vienë.

6. Aktivitet për rritje fondesh

Gjatë muajit nëntor D&E organizoi për të katërtin vit radhazi një event për rritjeve fondeve. Këtë vit, u organizua *një mbrëmje Gala* ku të ftuarit kontribuan përmes blerjes së biletave për eventin, blerjes së produkteve në një *Ankand të Heshtur*, produkte të cilat ishin dhuruar nga bizneset. Kontributi mund të bëhej përmes donacioneve në llogari të organizatës. Gjithashtu gjatë këtij eventit u lancua një këngë e kënduar nga Jualiana Pashadhe mbështetur nga D&E e cila synon ndërgjegjësimin e komunitetit mbi çështje të trafikimit.

Gjatë këtij eventit u arrit që të mblidhej *shuma prej 1.100.205 lekësh*



FIGURA 38



FIGURA 39

7. Publikime/Prodhime të D&E

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në partneritet me RGS “**Motrat e Bariut të Mirë**” dhe “**Franziskanerinnen von der Eeigen Anbetung, Olpe**” me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin në persona lançon për herë të parë këngën “**JETO**”, realizuar në bashkëpunim me këngëtareshen e njohur **Juliana Pasha**, Kompozitor **Adi Hila**, Teksti **Olti Curri**.



FIGURA 40



FIGURA 41



FIGURA 42



FIGURA 43